

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“PRONTO Real Estate” SHPK**

Ortaku themelues si më poshtë:

- “MC HOLDING” SHPK, shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NUIS M32115057E, e përfaqësuar nga administratori Mateo Curraj, i pajisur me letërnjoftim bashkëlidhur këtij akti themelimi; bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 11.06.2024, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

**Emri**

- 1.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “PRONTO Real Estate”.
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

**Forma**

- 2.1 Shoqëria tregtare “PRONTO Real Estate” ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

**Zyra Qendrore**

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “PRONTO Real Estate” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 3, Zona Kadastrale 2679, Nr. Pasurie 19/27/1, Kashar, Mëzez, Tiranë.
- 3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

**Objekti i Veprimtarisë**

- 4.1 Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Shitje blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme (real estate). Dhënie me qira e tyre.

**NENI 5**

**Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**

**Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

- 6.1 Shoqëria tregtare “PRONTO Real Estate” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.



**NENI 7**  
**Përgjegjësia e Ortakëve**

7.1 Ortaku/ët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “PRONTO Real Estate” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

**NENI 8**  
**Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “PRONTO Real Estate” SHPK është 5,000,000 (pesëmilion) lekë, i cili është nënshkruar rregullisht nga ortaku.

8.2 Ortaku “MC HOLDING” SHPK zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë nominale 5,000,000 (pesëmilion) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind për qind) në kapitalin e shoqërisë.

**NENI 9**  
**Organet e Shoqërisë**

9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

9.2 Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë. Shoqëria për efekt të aktivitetit që do të kryejë, do të ketë dhe një drejtues teknik.

**NENI 10**  
**Administratori**

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është znj. Marjana Curraj, mbajtëse e letërnjoftimit bashkëlidhur këtij akti themelimi.

**NENI 11**  
**Sekreti tregtar**

Ortaku/ët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “PRONTO Real Estate” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore**

**ORTAKU THEMELUES**  
**SHOQËRIA “MC HOLDING” SHPK**  
përfaqësuar nga administratori  
**MATEO CURRAJ**

*Mateo Curraj*

